



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.43, datë 28.09.2007

**“PËR MIRATIMIN DHE FINANCIMIN E PJESSHËM TË PROJEKTIT
“QËNDËR DITORE KOMUNITARE PËR TË MOSHUARIT, NË NJËSITË
BASHKIAKE NR.7 DHE NR.8”**

Bazuar në Ligjin Nr.8652, dt.31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 10, pika nr.3/II/c, Ligjit Nr.9355, dt.10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, V.K.M. Nr.265, dt.28.04.2005 “Strategjia kombëtare e shërbimeve shoqërore në Shqipëri”, V.K.M. Nr.823, dt.06.12.2006 “Mbi standartet e përkujdesit shoqëror në qendrat ditore për moshën e tretë”, si dhe V.K.B. Nr.23, dt. 30.04.2007 “Për miratimin e realizimit të Buxhetit të vitit 2006 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2007”. me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të miratojë projektin “Qëndër ditore komunitare për të moshuarit në Njësitë Bashkiake Nr.7 dhe Nr.8”, i cili do të realizohet nga Shoqata e Kryqit të Kuq Shqiptar, dega Tiranë, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës.
2. Të miratojë fondin prej 974.000 lekë, për financimin e pjesshëm të këtij projekti, duke filluar nga data 1 gusht 2007.
3. Efektet financiare do të përballohen nga fondi i miratuar me V.K.B Nr.23, dt. 30.04.2007 “Për miratimin e realizimit të Buxhetit të vitit 2006 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2007”, nga zëri “Projekte Sociale”.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi Drejtoria e Përkujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SOKOL DERVISHAJ

K R Y E T A R